

## **STATUTI**

### **SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

### **“Best Auto Albania” Sh.p.k.**

#### **KREU I**

#### **THEMELIMI, EMËRTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA SELIA, QELLIMI I VEPRIMTARISE**

##### **Neni 1 Themelimi**

Duke u bazuar në Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise dhe në ligjin nr.9901 date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare dhe ne ligjin nr.9723, date 03.05.2007 per Q.K.B-në.

Sot me dt.01.04.2021, në cilesine e ortakut Vladimir Maha, i biri Iljazit, i datelindjes 10.02.1985, lindur në Peshkopi dhe banues në Tiranë, me numer identifikimi personal I50210088F madhor në cilesine e plote juridike per te vepruar, themloi shoqerine tregtare "Best Auto Albania " Sh.P.K dhe vendosi unanimitisht te krijonë kete statut per krijimin e funksionimin e Shoqerise me Pergjegjësi të kufizuara( sh.p.k) sipas dispozitave ligjore te legjisllacionit ne fuqi.

##### **Neni 2 Themelues dhe ortake te shoqerise jane :**

2.1. Z.Vladimir Maha

##### **Neni 3 Shoqeria e krijuar eshte e llojit:**

3.1. " Shoqeri me Pergjegjesi të Kufizuar".

##### **Neni 4 Objekti i veprimtarise**

Objekti i veprimtarise do te jete si me poshte :

4.1. Sherbim parkimi, karrotreci, shitblerje me pakice te automjeteve te llojeve te ndryshme. Agjensi per dhenie me qera te automjeteve te perdorura. Agjensi komisionere dhe ndermjetesimi per shitjen e automjeteve te perdorura te te treteve, Import-eksport etj



#### **Neni 5**

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 100 000 lekete ndare ne 1 kuote me vlere nominale 100 000 leke per kuote ku:

Vladimir Maha zoteron kete kuote me vlere 100 000 leke.

Kapitali themelor eshte depozituar nga aksionaret ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimt te ortakeve, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, diten qe do te marre cilesine e personit juridik.

#### **Neni 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

#### **Neni 7**

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

#### **Neni 8**

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

#### **Neni 9**


Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

#### **Neni 10**

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj. Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

#### **Ortaku Themelues:**

Vladimir MAHA

Vladimir Maha  


# "BEST AUTO ALBANIA" SH.P.K

---

## AKT THEMELIMI

### I

## Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar

Sot, me 01.04.2021, une i nenshkuari Vladimir Maha, i biri Iljazit, i datelindjes 10.02.1985, lindur në Peshkopi dhe banues në Tiranë, me numer identifikimi personal I50210088F madhor në cilesine e plote juridike per te vepruar, regjistroj një Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin "Best Auto Albania " Sh.P.K .

### Neni 1

Une i nenshkuari Vladimir Maha, me vullnetin e tim te lire, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosa te krijojë Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin "Best Auto Albania "Sh.p.k., me kapital themeltar 100 000 Leke.

Selia e shoqerise ndodhet ne Tirane ne adresen: rruga "Mihal Dhimitri", Kashar, Ndertesa nr.8 , Tirane.

Ortaku i kesaj shoqerie do te jete Vladimir Maha.

Shoqeria "Best Auto Albania" Sh.p.k., ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

### Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij Akt Themelimi dhe Statutit mazuar mbi legjislacionin aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij Akt Themelimi dhe formon nje pjese integrale me te.

### Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe.

Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjithë ortakët e saj.

### Neni 4

Objekti i shoqerise : Sherbim parkimi, karrotreci, shitblerje me pakice te automjeteve te llojeve te ndryshme. Agjensi per dhenie me qera te automjeteve te perdorura. Agjensi komisionere dhe ndermjetesimi per shitjen e automjeteve te perdorura te te treteve, Import-eksport..



## **Neni 5 Kohezgjatja**

5.1. Shoqeria do te funksinoje nga data e regjistrimit në QKB per nje periudhe kohe të papërcaktuar.

## **Neni 6 Emertimi dhe selia**

- 6.1. Emertimi i shoqerise eshte "Best Auto Albania" shoqeri me pergjegjesi te kufizuar(Shpk).
- 6.2. Shoqeria ka te drejte te ndryshoje emrin , pergjegjesine dhe vendodhjen e saj duke bere regjistrimet perkatese ne QKB me vendim te Asamblese se Ortakeve
- 6.3. Selia e shoqërise ndodhet në adresen rruga "Mihal Dhimitri", Kashar, Ndertesa nr.8 Tiranë
- 6.4. Kontaktet e tjera vullnetare jane nr.cel: 0675555540 , emai: bestalauto@gmail.com.
- 6.5. Shoqeria do te regjistrohet ne QKB ne vijim te ligjit nr.9723 date 03.05.2007.
- 6.6. Shoqeria eshte themeluar me daten 01.04.2021 dhe do te filloje aktivitetin e saj me daten e regjistrimit ne QKB..

## **Neni 7 Qellimi i veprimtarise**

- 7.1. Shoqeria krijohet me qellim qe, themeluesit e saj te merren me ushtrim te veprimtarise se lire private, sipas objektit te veprimtarise se shoqerise, te perfitojme ne gjithe territorin e Republikes se Shqiperise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.
- 7.2. Shoqeria mund te krijojë adresa sekondare si filiale, dege, zyra përfaqesimi, dyqane dhe cdo veprimtari tjetër të lejuar nga dispozitat ligjore në fuqi brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë

## **KREU II**

### **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT, ADMINISTRATORET, PERGJESIA E THEMELUESVE**

## **Neni 8 Kapitali themeltar dhe kuotat**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte;

- 8.1. Kapitali ne para: 100.000 leke njeqind mije leke, i barabarte me nje kuote, i depozituar në perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, me pjesmarrje:
  - 8.1 a) Vladimir Maha 1(nje) kuote me kontribut ne para ne vleren nominale 100.000 (Njeqin mije leke) e cila zoterohet nga oratku i vetem që përfaqeson 100 (njeqind ) % te kapitalit.
- 8.2. Kapitali në natyre: Krahas ecurise veprimtarise ekonomike finaciare te shoqërisë që do ti



krijohen, kontributet e saj mund të jenë edhe në natyre (pasuri të luajshme apo të paluajshme ose në të drejta të vlersueshme në para), që do të vendosë në të ardhmen Asambleja e Ortakeve të shoqërisë.

8.3. Kuotat e nenshkruara me kontribut në para mund të shlyhen edhe pas regjistrimit të shoqërisë në QKB.

8.4. Pjesët e kapitalit themeltar kalojnë përsoneve të tretë (jashtë shoqërisë) vetëm me miratimin e Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit**

9.1. Kapitali do të rritet ose do të zvogelohet në përputhje të ecurisë së veprimtarisë ekonomike e tregtare si dhe vendimet që do të marrë në të ardhmen Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve të shoqërisë.

9.2. Gjithashtu, zmadhimi dhe zvoglimi i kapitalit regjistrohet në QKB dhe në Organet Tatimore sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe të Statutit të Shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Transferimi i kapitalit**

10.1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

10.3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU III**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE MBLEDHJA E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME, MARRJA E VENDIMEVE ,NDARJA E FITIMIT, VAZHDIMI I SHOQËRISË NGA TRASHIGIMTARET, E DREJTA E VOTES, DEKLARIMI I DIVIDENTI,**

## **Neni 11**

### **Organi vendimmarres**

11.1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

11.2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

11.3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve



per shoqerine per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
- dh) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

11.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete.

11.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

11.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

## **Neni 12**

### **Menyra E Thirrjes Se Mbledhjes Se Asamblese Se Pergjithshme**

12.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

12.2. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

## **Neni 13**

### **Kuorumi**

13.1. Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

13.2. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

13.3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përcaktuar më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## **Neni 14**

### **Marrja e vendimeve**

14.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

14.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;

14.3. Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## **Neni 15**

### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

15.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

15.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **Neni 16**

### **Administrimi**

16.1. Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizike si administratorë të shoqërisë. Afati i emerimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërteritjeje. Emerimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.

16.2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emrohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emerim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.



16.3. Z. Ervis Xheli eshte Administrator i shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

## **Neni 17**

### **Kompetencat e Administratoreve**

17.1. Administratoret kane te drejte e detyrohen te:

- a) kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) perfaqesojne shoqerine tregtare;
- c) kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- ç) pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- d) krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- dh) kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- e) raportojne perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- e) kryejne detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

17.2. Administratoret jane te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, ne rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.

-shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

-shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 per qind te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.

17.3. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

17.4. Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 18**

### **Pergjegjesite e Administratorit**

18.1. Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve,





per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

18.2. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

18.3. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administrator detyrohet:

18.3.1. a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshem.

18.3.2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjen ndaj shoqerise per çdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

18.3.3. Nese administratori vepron ne kundersizim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarare.

18.4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersizim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) u kthen ortakeve kontributet;

b) u paguan ortakeve interesa apo dividende;

c) u shperndan aktivet shoqerise;

ç) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

18.5. Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngrene padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

## KREU IV

### VITI FINANCIAR- EKSPERTET

## **Neni 19 Viti Financiar**

19.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti I pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

## **Neni 20 Ekspertet**

20.1. Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

20.2. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

## **KREU V PRISHJA –RIORGANIZIMI I SHOQERISE**

### **Neni 21 Prishja dhe Likuidimi**

21.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi I veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;
- d) me vendim te gjykates;

21.2. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese“ Shoqeri ne likuidim e siper “.

21.3. Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

21.4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.



21.5. Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emerimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## **Neni 22**

### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

22.1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

## **Neni 23**

### **Baza Ligjore**

23.1. Shoqëria do të ketë vullnet dhe saj me përmbajtje "Best Auto Albania" Shpk

23.2. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë Statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

23.3. Ky statut u hartua në 5 (pese) kopje në gjuhën Shqipe, duke patur secila kopje fuqi të njëjta ligjore.

23.4. Në rastet e likuidimit të Shoqërisë sipas legjislativës në fuqi, pushon së vepruari dhe Statuti siç është.

23.5. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **ORTAKU I SHOQËRISË "BEST AUTO ALBANIA" SH.P.K, TIRANË**

**Vladimir MAHA**

Vladimir Maha

